**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KUVENDI**

# VENDIM

**Nr. 92/2017**

## PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Struktura organizative e personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 29.9.2017

*Lidhja nr. 1*

## ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

| Funksioni organik | Klasifikimi i pagës | Numri |
|---|---|---|
| | | **(2)** |
| **I. KRYETAR** | G3* | 1 |
| Sekretar | Sekretar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit** | 1 |
| **II. KOLEGJI I GJYQTARËVE** | | **(6)** |
| Gjyqtarë | G3* | 6 |
| **III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR** | | **(10)** |
| Këshilltarë juristë | 80% e G3* | 7 |
| Këshilltarë ekonomistë | 80% e G3* | 3 |
| **IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM** | I-a | 1 |
| **V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN** | | **(10)** |
| Drejtor | II-b | 1 |
| Specialist sekretarie gjyqësore | IV-a | 3 |
| Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve | IV-b | 1 |
| Përkthyes | II-b | 3 |
| Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë | III-a | 1 |
| Specialist pritje me popullin | IV-b | 1 |
| **VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE** | | **(8)** |
| Drejtor | II-b | 1 |
| Specialist financë/buxhet | III-b | 1 |
| Specialist i burimeve njerëzore | III-b | 1 |
| Specialist IT | III-b | 1 |
| Specialist protokoll/arkiv | IV-b | 1 |
| Magazinier | VII | 1 |
| Punonjës pastrimi | III | 1 |
| Shofer | V | 1 |
| **Gjithsej** | | **37** |

*Shënim:*

**Paga e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit përllogaritet me këtë formulë: G3 + 10% G3 + shtesën për vjetërsi (e barasvlershme me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".*

***Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas VKM nr. 187/2017.*

*Lidhja nr. 2*

## STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TE POSACEM TE APELIMIT

